



P

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA HIMARË**  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 60 prot.

Himarë, më 22.12.2023

**PROCESVERBAL I KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË, ZBARDHUR NGA  
ORGJINALI, PËR MBLEDHJEN E RADHËS TË MUAJT DHJETOR, DATË  
22.12.2023**

Mbledhja zhvillohet në njësinë administrative Horë – Vranisht ,fshati Kuç – Buronjë.

**1. Në mbledhje marrin pjesë këshilltarët:**

Gjergji Iliadhi, Elisabeta Lamaj, Dhimitër Kapaj, Loreta Isufi, Thodhori Foto, Mirka Gjiçali, Milto Nika, Aleks Llazari, Silva Burbo, Fuat Mati, Timoleo Gërdhuqi, Lenica Kocani, Afrovita Dhimojani, Nertila Husi, Artan Bala, Thëllëza Kokaveshi, Maks Vlashi, Qirjako Mërkuri, Artionil Shirokaj.

**2. Mungojnë:** Miltiadh Prifti, Nikolinë Laska ( me arsye)

**Në mbledhje marrin pjesë të ftuar:**

Drejtoritë e drejtorive, administratorët e njësive të Bashkisë Himarë, kryetarët e fshatrave, banorë.

Sigurohet mbi 50% pjesëmarrja e këshilltarëve.

Mbledhjen e hap Kryetari i Këshillit Z. Dhimitër Kapaj.

**3. Miratimi i rendit të ditës.**

**Kryetari Këshillit:-** Jeni dakort me rendin e ditës? PO -Këshilltarët.

**Miratohet rendi ditës.**

**Pika e dytë e rendit të ditës**

Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për miratimin e planit të këshillit bashkiak, planit të konsultimeve dhe planit të buxhetit për vitin 2024”.

**Këshilltari :Fuat Mati,** Në bazë të rregullores do të doja në të gjitha mbledhjet të kemi informacion mbi ligjshmërinë e materialeve që miratojmë në këshill, ky informim t’i shkojë

kryetarës dhe nënkryetarit të grupit tonë, pasi ne si grup këshilltarësh nuk kemi miratuar një projektvendim për marrëveshjen e ujësjellës Himarë.

**Sekretarja e Këshillit :-** çdo vendim i Këshillit bashkiak i miratuar dhe legjitimuar nga Prefektura ju bëhet e ditur në fillim të çdo mbledhje që zhvillojmë, plus janë të publikuara në web, në adresën e Bashkisë Himarë.

**Kryetari i këshillit: Po,** patjetër çdo akt ligjshmërie do t'ju Komunikohet.

**Këshilltarja: Thëllëza Kokaveshi:-** Kam një propozim, të bëjmë një analizë ne si këshill një herë në katër muaj, për planin e Këshillit.

**Këshilltari: Timoleo Gërdhuqi:-** Plani vjetor kalon në parim kurse analiza financiare është në buxhet.

**MIRATOHET VENDIMI NR.51 PËR MIRATIMIN E PLANIT TË KËSHILLIT, PLANIT TË KONSULTIMEVE DHE PLANIT E BUXHETIT ,ME 19 VOTA PRO, O KUNDER, O ABSTENIM**

**Pika 3 e rendit të ditës.**

Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit "Për paketën fiskale, për disa ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.54 datë 25.10.2021 -2022

**Këshilltari ,Timoleo Gërdhuqi :-** Kush ka propozime. mund t'i shpreh.

**Këshilltarja, Silva Burbo:-** Mbasi i shqyrtuar si komision kërkojmë nga specialisti një informacion më të detajuar.

Jep shpjegim drejtori përkatës :- e vetmja që mund të ndryshojmë është taksa e fjetjes në hoteleri, të gjitha subjektet e hotelerisë janë të regjistruara.

**Këshilltarja, Silva Burbo:-** Ne si grup dalim me disa propozime 1. Taksa e fjetjes në hotel të shkoj në 60 -70 ditë.

**Këshilltari ,Maks Vlashi:-** nuk jam dakort.

2. Taksa e përkohëshme, të hiqen bar- kafet dhe të ngelen hotelerit dhe restorantet nga kjo taksë.

**Këshilltari, Timoleo Gërdhuqi:-** nga kjo taksë nuk kemi të drejt të heqim, Ju lutem bëjmë propozimet dhe i hedhim në votim.

**Kryetari këshillit:-** po.

**Drejtori ,Laert Mezani:-** Përsa u përket taksave janë të përkohshme dhe këto fonde do të shërbejnë për mirëmbajtjen e rrugëve, janë subjekte që ushtrojnë aktivitet në vijën bregdetare në Himarë, taksa e fjetjes në hotel nuk ka punë me 70 ditë, paguan aq sa ke, subjektet sjellin regjistrat dhe paguajnë. Hoteleria 130/lekë -klient, tarifet janë sipas njësisë.

**Këshilltarja, Thëllëza Kokaveshi:-** pse është rritur tarifa e pastrimit për familjarët? Përlllogaritja e pastrimit për familjarët 60% është kostoja që duhet të mbulojnë subjektet për pastrimin.

**Këshilltarja ,Silva Burbo:-** të funksionojnë me libër klienti bizneset.

**Këshilltarja, Elisabeta Lamaj:-** tarifa e kullotave sa është vendosur?

**Kryetari këshillit:-** nuk jam dakort me tarifën e kullotave dhe vaditjes ,duhet t'i heqim,i propozoj.

**Këshilltarja,Thëllëza Kokaveshi:-** propozoj të zbutet tarifa e pastrimit.

**Këshilltari ,Timoleo Gërdhuqi:-** tarifa e pastrimit për familjarët të ulet në 30% ,tarifa e pastrimit dhe gjelbërimit për supermarketet të rritet 5-fish,për restaurantet të rritet tarifa,te biznesi i vogël nuk mendoj ta ndryshojmë taksën,taksa te biznesi i madh të rritet në 30%.

**Këshilltari,Milto Nika:-** çdo subjekt duhet të jetë i kontrolluar,nuk jam dakort me taksën e gjelbërimit,tarifa e restoranteve të ulet.

**Propozimet: 1. Tarifat e supermarketeve 5-fish rritje – pro këshilli ,2. Të ulen 30% tarifat për familjarët – pro këshilli . 3. Për restaurantet 30% tarifa – pro këshilli . 4.Kanalet vaditëse të hiqet fare tarifa – pro këshilli. 5.Rritja e sezonit turistik nga 75 ditë 60 ditë,të shkojë për zonën bregdetare 75 ditë – pro këshilli.**

**Miratohet Paketa Fiskale me ndryshimet e përmendura më lart ,të cilat do të pasqyrohen në zbardhje të vendimit.**

**Miratohet vendimi nr.52 ,Paketa Fiskale me 19 vota pro,0 kundër, 0 abstenim.**

**Pika 4 e rendit të ditës.**

Shqyrtimi i prioriteteve të Bashkisë Himarë për vitin 2024.

**Këshilltarja,Silva Burbo:-** për prioritet e Bashkisë Himarë në mbledhjen e komisionit propozuam një kënd lojrash në Himarë.

**Miratohet vendimi nr.53,për prioritetet e Bashkisë Himarë,2024.**

**Pika 5 e rendit të ditës.**

Shqyrtimi i projektvendimit për përcaktimin e numrit maksimal të punonjësve të policisë bashkiake.

**Këshilltarja,Afrovita Dhimojani:-** kjo nuk është pasqyruar në buxhet

**Këshilltarët:-** është pasqyruar.

**Këshilltari ,Fuat Mati:-** mendoj të shikohet me prioritet numri në shërbim të sezonit turistik sepse ka të bëjë me mbarëvajtjen e turizmit.

**Këshilltarja,Afrovita Dhimojani:-** propozojmë numri punonjësve të policisë të qëndroj 14 dhe të shtohen në sezon.

**Kryetari këshillit:-** E hedhim në votim? Pro – këshilli.

**Miratohet vendimi nr.54 për përcaktimin e numrit maksimal të punonjësve të policisë bashkiake me 19 vota pro,0 kundër, 0 abstenim**

**Pika 6 e rendit të ditës.**

Shqyrtimi i projektvendimit për numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë,2024.

Miratohet vendimi nr. 55 për numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë,2024 me 19 vota pro, 0 kundër ,0 abstenim.

Pika 7 e rendit të ditës.

Shqyrtimi i numrit të punonjësve me kontratë të Bashkisë Himarë për vitin 2024.

Miratohet vendimi nr. 56 për punonjësit me kontratë në Bashkinë Himarë për vitin 2024 me 19 vota pro, 0 kundër ,0 abstenim.

Pika 8 e rendit të ditës.

Shqyrtimi i projektbuxhetit për vitin 2024,Bashkia Himarë

**Këshilltarja Silva Burbo :-** na është dhënë një tabelë projektbuxhet afatmesëm ku shifrat nuk përputhen.Kur bëme parashikimin është tabela që kemi sjellë PBA ,kemi bërë e dua ndryshime në taksa në 2024,si taksa në infrastrukturë,bujqësi e të tj.

**Kryetari Këshillit:-** janë bërë propozimet nga dëgjesat publike dhe janë marr kërkesat nga kryetarët e fshatrave,nëse ka propozime për ndryshime?

**Drejtori ,Laert Mezani:-** të gjitha propozimet në buxhet t'i paraqiten administratës për t'u pasqyruar në muajin mars,administrata duhet të bëjë projektet.

**Këshilltari,Qirjako Mërkuri:-** nuk jam kundër për buxhetin por doja disa ndryshime ne rastin e festave si dekor,drita në fshatin Borsh.

**Drejtori ,Sokrat Kreku:-** nuk pati fond viti 2023 .

Qazim Pali ka nevojë për një qëndër sociale ku mund të mblidhemi,të bëhet një pjac ose të restaurohet ,ta shikojë si mundësi Bashkia.

**Këshilltarja,Thëllëza Kokaveshi:-**shikoj tarifa të larta në buxhet si p.sh,shpenzimet për detergjentet në shkolla,pastrimin,materiale higjenosanitare,shkollat nuk mbulohen me këto edhe pse çmimet janë të larta,zbukurimet për festa,ku përdoren këto? Ngrohja në shkolla mungon,një prizëm të çojmë bie automati. Dua një përgjigje ,institucionet shkollore që mbulon Bashkia kanë mungesa dhe ku shkojnë ?

**Uran Dulaj:-** është prokurim publik,procedurë ligjore,procedurat ngecin rrugës,shtyhen. Vitin e kaluar patëm problem me procedurën. ATP nuk na e lejon si procedurë.

**Këshilltarja,Thëllëza Kokaveshi:-** çmimi i bibliotekave nëpër shkolla,fondi 10 milion lekë,unë maturantëve të gjimnazit tim ua kam blerë vetë të gjitha sepse shkolla nuk ka,asnjë fond nga Bashkia dhe shpenzime,shpenzime për ngrohje që nuk funksionojnë,rrjetet të amortizuara.

**Drejtori ,Laert Mezani:-** qëndrojnë problematikat ndaj sjellim këtë vit këtë fond me këtë buxhet.

**Këshilltarja ,Afrovita Dhimojani:-** për shpenzimet ligjore janë 320 mijë euro për çfarë përdoren për 2024?

**Drejtori ,Laert Mezani:-** është një vendim gjykate,vendim prishje subjekti,është detyrim i Bashkisë.

**Këshilltarja ,Afrovita Dhimojani:-** koshat dhe mbetjet,shpenzime për mirëmbajtje,sa është tenderi për pastrimin e Bashkisë,ne e tenderojmë dhe pse duhet Vlefta në lekë?

**Këshilltari ,Timoleo Gërdhuqi:-** ose të biem në parim dakort për buxhetin pse ta marrim pikë për pikë dhe bëjmë disa propozime,për mua e shqyrtojmë në muajin mars.

**Kryetari këshillit:-** Nëse fillojmë ta marrim pikë për pikë nuk dalim gjëkund dhe as kemi për të përfunduar sot,në buxhet ka pika që nuk jam dakort,drejtorët duhet të investojnë më shumë fshatrave,këto që kanë sjell në buxhet janë nga dëgjesat publike dhe shumica e këshilltarëve nuk morën pjesë në degjesë,nëse mendoni se këto investime janë të mjaftueshme,nëse doni të ngremë një grup pune për inspektim,ne kemi problematika me tenderit dhe ndaj jemi këtu ku punonjësit e administratës dhe të Bashkisë duhet të jenë më korrekt në detyrë.

Jeni dakort ta miratojmë dhe ndryshimet i pasqyrojmë në muajin mars?

**Këshilltarja,Lenica Kocani:-** kërkoj një bilanc për vitin 2023 në shpenzime!?

**Këshilltari ,Milto Nila:-** jam dakort për disa ndryshime dhe dua ta miratojmë me ndryshime,pasi ne do ta diskutojmë edhe në muajin mars,mbështes këshilltarët për ndryshimet dhe investimet e shumta duhet të hidhen fshatrave.

**Këshilltari ,Timoleo Gërdhuqi:-** mendoj ta kalojmë në parim dhe ndryshimet i bëjmë në muajin mars.

**Miratohet vendimi nr.57,për buxhetin me 13 vota pro, 6 kundër, 0 abstenim.**

**Pika 9 e rendit të ditës.**

**Miratohet vendimi nr.58 për bursë për nxënësin Marjol Vangjel Molla. ( 19 vota)**

**Miratohet vendimi nr.59,për bursë për nxënësin Samuel David Basho. ( 19 vota)**

**Miratohet vendimi nr.60,për bursë për nxënësin Leonard Ilias Alikaj. (19 vota)**

**Miratohet vendimi nr.61,për bursë për nxënësin Xhartlis Thodhori Baraj. ( 19 vota )**

**Pika 10 e rendit të ditës.**

**Miratohet vendimi nr.62 ,mbi emërtimin e sallës polifunkionale “Neço Muko” Himarë. (19 vota)**

**Pika 11 e rendit të ditës.**

**Shqyrtimi i zgjedhjes së kryesisë dhe kryetarit të fshatit Dhërmi.**

**Këshilltarja,Silva Burbo:-**nuk jam dakort me zgjedhjet në Dhërmi,ka pasur shkelje kompetencash dhe ligjore,ku mungonte një anëtarë komisione dhe sekretarja e Këshillit mori pjesë në procesin zgjedhor për mbarëvajtjen,nuk jam dakort me pjesëmarrjen e policisë.

**Kryetari këshillit: -** procedura ka qenë e rregullt,i kam ndjekur vetë si zgjedhje .

**Këshilltari ,Gjergj Iliadhi:-**kam qenë anëtarë komisioni dhe çdo gjë ka qenë korrekte.

**Këshilltari ,Fuat Mati:-** për shkak të shkeljes së rregullores nuk jam dakort.

**Miratohet vendimi nr.63 ,mbi zgjedhjen e kryesisë dhe kryetarit të fshatit Dhërmi. (13 vota pro, 6 kundër)**

**Pika 12 e rendit të ditës .**

**Miratohet vendimi nr.64,për dhënie e ndihmës ekonomike periudha 1 - 31 tetor nga fondi i kushtëzuar 6% I bllok – ndihmës ekonomike,2023.**

**Pika 13 e rendit të ditës.**

**Miratohet vendimi nr.65, për dhënie e ndihmës ekonomike për periudhën 1- 30 nëntor nga fondi 6% I bllok – ndihmës ekonomike, 2023.**

**Të ndryshme – nuk u shqyrtuan.**

**Mbyll mbledhjen Kryetari Këshillit .**

**Sekretari**

**Elena Memushaj**